Kronikë

# Vau i Dejës/ Kishte kultivuar 180 bimë kanabis, arrestohet 27-vjeçari! Në kërkim një i mitur

*Një 27-vjeçar i cili ishte në kërkim ka rënë në prangat e policisë pasi dyshohet se kishte kultivuar 180 bimëve narkotike kanabis në fshatin Mnelë*




Redaksia
31 Korrik, 13:50 | **Përditesimi: 31 Korrik, 14:12**

Share

**Vau i Dejës** - Një 27-vjeçar i cili ishte në kërkim ka rënë në prangat e policisë pasi dyshohet se kishte kultivuar 180 bimëve narkotike kanabis në fshatin Mnelë.

Në kërkim është shpallur bashkëpunëtori i tij 17-vjeç, ndërsa në gjendje të lirë do të hetohet babai i 27-vjeçarit  pasi gjatë kontrollit në banesë blutë gjetën një armë gjahu që e mbante pa leje.

Lënda narkotike u asgjësua nga uniformat blu gjatë muajit të kaluar (qershor).



LEXO EDHE:
**Shkodër/ Plagosi me thikë një 42-vjeçar për motive të dobëta, policia arreston autorin (VIDEO)**

**Njoftimi i policisë:**

*Në vijim të veprimeve hetimore dhe operacionale në kuadër të operacionit policor antikanabis, të koduar "Koordinata", specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vau i Dejës kapën dhe ndaluan shtetasin P. N., 27 vjeç.*

*Ky shtetas ishte shpallur në kërkim pasi nga hetimet e kryera me metoda proaktive, në drejtimin e Prokurorisë, dyshohet se një bashkëpunim me një 17-vjeçar, kanë kultivuar 180 bimë të dyshuara narkotike Cannabis Sativa, në fshatin Mnelë, të cilat janë janë gjetur dhe asgjësuar nga shërbimet e Policisë, në muajin qershor. Punohet për kapjen e 17-vjeçarit.*

*Në vijim të veprimeve procedurale, u krye kontroll në banesën e shtetasit Z. N., 62 vjeç, babai i shtetasit të arrestuar, ku u gjet dhe u sekuestrua një armë gjahu që 62-vjeçari e mbante pa leje. U referuan materialet procedurale në Prokurori dhe nisi procedimi penal për 62-vjeçarin.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/I.M/Shqiptarja.com

TAG: kanabis Shkoder

Komento

**Komente**

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 30 Korrik, 15:42
**Prokuroria, GJL e Dhoma Avokatisë kundër Kodit Penal, a duhet ndryshuar drafti?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera



Itali/ Zbulohet sera 1 mijë m2 e mbjellë me kanabis, arrestohet një shqiptar! Rreth 300 mijë euro drogë e sekuestruar
30 Korrik, 22:48



Bashkia Shkodër shkarkoi dy aktorët e teatrit 'Migjeni', Shkreli dhe Doda: Vendimi me prapavijë politike
Ergys Kavaja
30 Korrik, 15:42



Do i japë Shkodrës hyrjen dinjitoze, punime intensive në kantierin e rrugës dhe urës nga Bërdica në Bahçallëk! Do zhvillojë turizmin
30 Korrik, 10:37



Shiste hashash me doza në Kuçovë, në pranga 'qytetari'! 31-vjeçarit i gjenden drogë, 5 peshore dhe rreth 300 mijë lekë cash (EMRI+VIDEO)
30 Korrik, 10:03



Benet Beci sqaron largimet nga Teatri Migjeni: Disa aktorë nuk i përmbushin pritshmëritë
29 Korrik, 21:50



Velipojë/ I moshuari zaptoi plazhin, Policia e merr nën akuzë dhe i sekuestron 80 çadra dhe 160 shezlongë (VIDEO)
29 Korrik, 14:10



VIDEO/ Sezoni turistik, lirohen plazhet publike në Velipojë
29 Korrik, 08:18



Shkodër/ Lidh Shqipërinë me Malin e Zi dhe zhvillon turizmin, punime me ritme të larta në rrugën Shirokë-Zogaj (VIDEO)
28 Korrik, 16:53



Tepelenë/ Shiste hashash me doza në qytet, në pranga 'dealer-i' 53-vjeçar! I gjendet drogë edhe në banesë (VIDEO)
28 Korrik, 11:46



Vau i Dejës/ I vuri flakën varrezave të fshatin Barbullush, arrestohet piromani 80-vjeçar! I 'skeduar' për akte të ngjashme (EMRI+VIDEO)
28 Korrik, 09:58



Aksioni i lirimit të hapësirave publike, Rama publikon videon: Shkodra ka nisur të marrë frymë lirisht
27 Korrik, 13:31



Festivali 'Za Fest' dhuron emocione në natën e dytë në kalanë e Rozafës! Performancë edhe nga grupi i njohur 'Rednex'
Ergys Kavaja
26 Korrik, 15:47

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje